



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 nëntor 2022
Nr.ref.:RK 2077/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI150/21

Parashtrues

“Elezaj” SH.P.K

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr. 29/2021],
të 29 prillit 2021 të Gjykatës Supreme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gerxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania “Elezaj” SH.P.K me seli në fshatin Dresnik, Komuna e Klinës e përfaqësuar nga Ardian Deskaj, avokat nga Klina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ. nr. 29/2021], të 29 prillit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [AA.nr.571/2020], të 11 shkurtit 2020, të Gjykatës se Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [A.nr.621/13], e 25 gushtit 2020, të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 gusht 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 8 tetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 13 tetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lendes rezulton se parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejme KPMM) për të marrë licence për hulumtimin të rërës dhe zhavorrit.
10. Më 5 gusht 2011, KPMM përmes Aktvendimit [4567] aprovoj me kusht kërkesën [nr 480] e parashtruesit të kërkesës duke i lëshuar "*Leje për Aktivitete të Veçanta – Seperacion*" në vendin e quajtur Grabanice në Komunën e Klinës për një periudhë prej 3 viteve duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara aty, respektivisht duke iu nënshtruar kushteve standarde të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, specifikisht kushteve standarde të përcaktuara në nenet 40, 41 dhe 42.

11. Nga shkresat e lendes kuptohet se më 2 nëntor 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerri Vendimin [02/46] lidhur me ndalimin e eksploatimit të materieve inerte nga shtrati, brigjet dhe hapësirat e lumenjve në gjithë territorin e Kosovës. Gjithashtu, me 17 dhjetor 2011, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) kishte nxjerr Njoftimin për pezullimin e të gjitha pëlqimeve nga kjo ministri.
12. Më 12 janar 2012, KPMM duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Vendimin [02/46] e Qeverisë së Republikës së Kosovës, morri Aktvendimin [165], përmes të cilit *"Pezullohet Licenca me Nr.270/KPMM/2011 me nr. aplikacioni 480 e kompanisë Elezaj Sh.p.k për Licence Leje për aktivitete të Vecanta - Seperacion për rere dhe zhavorr, e cila gjendet në Grabanice dhe gjendet në Komunën e Kline..."*. Në Aktvendim ceket se *"Licenca Nr.270/KPMM/2011 e Kompanisë Elezaj Sh.p.k ka pasur afat ligjor që nga dt.11.08. 2011 deri me dt.10.08. 2014"*. Gjithashtu, në aktvendim theksohet se *"Pezullimi vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër."*
13. Më 25 janar 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë [nr. 277] në shkallën e dytë në KPMM kundër Aktvendimit [165].
14. Më 17 prill 2013, KPMM përmes Vendimit [nr.075/2013] refuzoi ankesën [nr. 277] e parashtruesit dhe konfirmoi Aktvendimin [165] e shkallës së parë i dt. 12 janar 2012, për pezullimin e Lejes së Aktivitetit të Veçantë [nr. 270/KPMM/2011].

Procedura gjyqësore për anulimin të Vendimit [nr.075/2013] të KPMM-së me të cilin i ishte pezulluar licenca

15. Më 7 maj 2013, kundër vendimeve të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore dhe në mbështetje të kësaj, përmes kërkesës për plotësim të kërkesëpadisë së 21 janarit 2014, parashtruesi kërkoi anulimin e Vendimit [nr.075/2013] të KPMM-së me të cilin i ishte pezulluar licenca, duke pretenduar aplikim të gabuar të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe anulimin e Vendimit [02/46] e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe kërkoi kompensimin e dëm të vlerë prej 1.418.650.00 euro, në emër të fitimit të humbur. Parashtruesi gjithashtu kishte propozuar caktimin e masës së përkohshme për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit [nr.075/2013] të KPMM-së.
16. Më 31 gusht 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.621/13] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se vendimi i atakuar është në interes të përgjithshëm dhe obligator, si dhe zbatimi i tij është në pajtim me Vendimin [02/46] të 2 nëntorit 2011, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër vendimit të lartcekur në Gjykatën e Apelit duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material, me propozim që të priset Aktgjykimi [A.nr.621/2013] i datës 31 gusht 2017, dhe lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
18. Më 19 shtator 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.474/17] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [A.nr.621/2013] i datës 31 gusht 2017. Gjykata e Apelit theksoi që parashtruesi nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij, vendimi i atakuar nuk është nxjerr në shkelje të dispozitave procedurale dhe nuk është vërtetuar gabimisht gjendja faktike dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit [parashtruesit].

19. Ne arsyetimin e Aktgjykimit [AA.nr.474/17], Gjykata e Apelit theksoi se në tërësi e aprovon Qëndrimin juridik të gjykatës se shkalles së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj “për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkalles së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative..., dhe se “në bazë të provave të lartcekura, vërtetohet se vendimet e KPMM-se, janë në interes të përgjithshëm dhe nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 84, 85 dhe 86 si dhe nenit 101 par.3 të LPA-se, se janë të qarta dhe të kuptueshme dhe përmbajnë arsye për aplikim të drejtë të dispozitave ligjore si dhe mbi faktet vendimtare.

Procedura lidhur me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [AA.nr.474/17] të Gjykatës së Apelit

20. Më 7 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në nenin 55, 57 dhe 62 të Ligjit nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejme: Ligji për Konfliktet Administrative) parashtroi kërkesë për rishikimin e procedurës dhe vazhdimin e procedurës në lenden Anr.621/13, respektivisht anulimin e Aktgjykimit [A.nr.621/13] të 31 gushtit 2017, të Gjykatës Themelore dhe të vendimit [nr.075/2013] të 17 prillit 2013, të KPMM-së. Parashtruesi në kërkesën e tij kishte propozuar “që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesa e sajë, si zgjerimi i padinë me datën 21.01.2014, ashtu që të anulohet Aktvendimi i Komisionit për Miniera dhe Minerale-Komisionit për ankesa nr. KA nr.075/2013 i datës 17.04.2013, si dhe ose të kompensohet demi në vlerë prej 1,418.560.00 012€”.
21. Më 25 gusht 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A.nr.621/13] duke u bazuar në nenin 55 të Ligjit për Konfliktet administrative refuzoj kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se parashtruesi nuk i ka bërë të besueshme pretendimet me ndonjë fakt të bazuar në prova konkrete se, ekziston baza ligjore për rishikim të procedurës. Konkretisht, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.621/13] kishte arsyetuar “padiësja nuk e arsyeton asnjërën nga bazat ligjore që do të mundësonin rishikimin e procedurës në rastin konkret, ndërsa prova e re e paraqitur nga padiësi nuk ka ndikim në vendosje ndryshe nga ajo e vërtetuar.”
22. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankese në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të priset vendimi i kontestuar dhe lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore.
23. Më 11 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.571/20] refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoj Aktgjykimin [A.nr.621/13] e 25 gushtit 2020, të Gjykatës Themelore.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqit kërkesë për rishikim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë në Gjykatën Supreme duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të priset vendimi i kontestuar.
25. Më 29 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr. 29/2021] refuzoj kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se ky i fundit nuk ka ofruar prova në bazë të cilave do të justifikohet kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor, ashtu si parashihet sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 55 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta respektivisht Aktgjykimi i kontestuar [ARJ. nr. 29/2021] i 29 prillit 2021 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
27. Sipas parashtruesit të kërkesës *"Elezaj SH.p.k është paditur nga S. B. dhe S. B. për kompensim demi, për shkak të mos përmbushjes së Kontratës së Elezaj Sh.p.k e ka lidhur me ta, për dhënien e tokës në shfrytëzim për eksploatim të rërës dhe zhavorrit, në pronat e tyre."*(Sqarim: nga shkresat e lendes vërehet që marrja e ftesës dhe padisë së S.B dhe S.B ndaj parashtruesit të kërkesës ishte e datës 21 korrik 2020).
28. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon se kontratat e lidhur me palët e treta pas marrjes së licencës së 5 gushtit 2011, kanë mbetur të pazbatuar dhe si pasoje e kësaj ndaj parashtruesit të kërkesës i janë ngritur padi nga palët e treta për mos përmbushje të kontratave, dhe tashmë këto rrethana nuk janë vlerësuar si fakte të reja nga gjykatat e rregullta për aprovim të kërkesës të rishikim të vendimit në favor të parashtruesit të kërkesës.
29. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson *"Të tria Gjykatat e kanë refuzuar të drejtën e Elezaj" SH.P.K për rishikim të vendimit sipas neneve 55, 57, 62 të Ligjit për Konfliktet Administrative"*
30. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson *"Arsyetimi i Gjykatave të rregullta nuk qëndrojnë sepse Aktgjykimi me të cilin është refuzuar padia është i vitit 2017, ndërsa "Elezaj" SH.P.K ka mësuar për provat e reja në vitin 2020. Shteti e ka shtyre "Elezaj" Sh.P.K. të hyjë në obligime dhe tani nuk përgjigjet."*
31. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se *"refuzimi i gjykatave që të mos i marrin parasysh se faktet të reja se paditë e personave të treta kundër "Elezaj SH.P.K" është shkelje e Ligjit për konfliktet administrative dhe nenit 54 të Kushtetutës."*
32. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson *"Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është e pavarur nga Qeveria e Kosovës, në Ushtrimin e Funksioneve të saj. Komisioni është dashur që vendimet e saj të bazojnë në Ligj për Miniera dhe Minerale si në momentin e dhënies së licencës, ashtu edhe në pezullimin e saj, e jo në vendimet e Qeverisë". Duke u bazuar në përmbajtjen e nenit 55 paragrafi 3 Ligjit për Miniera dhe Minerale parashtruesi thekson "KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas këtij ligji." Ky Ligj ka hyrë në fuqi me datën 09.08.2010. Ky Ligj ka qenë në fuqi në momentin kur është dhënë licenca, dhe në momentin kur është pezulluar Licenca. Vendime të tilla të institucioneve të pavarura krijojnë pasiguri juridike të cilat shkaktojnë dëm të mëdha materiale, dhe frikë për investitorë potencial nga Kosova dhe të shtetas të huaj. Por Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e refuzojnë kërkesën për rishikim të vendimit, sepse kështu ju vije me lehtë, duke ia shkelur të drejtat ligjore dhe kushtetuese "Elezaj" Sh.P.K..*
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të përsëritet procedura në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sepse sipas parashtruesit *"ka baze për përsëritje të procedurës apo rishikim të vendimit"*. Parashtruesi thekson se: *"Nëse përsëritet procedura, nëse është e pamundur që të vazhdohet Licenca, të pakten "Elezaj" SH.P.K të kompensohet nga Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale, sepse "*

Elezaj" Sh.P.K i eshte shkaktuar dem i madh material, ka hyre ne obligime duke blere makineri te shtrenjta, ka marr patundshmëri me qira per ta shfrytezuar, ka humbur 2 vite kohe dhe shpenzuar shuma me medha parash per ta marr licencën, dhe pas 5 muajve i pezullohet me arsyetimin se kështu ka vendos qeveria."

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 55

[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 13

(E Drejta për Zgjidhje Efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.

Ligji Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale

Neni 5

Llojet e Licencave dhe Lejeve

1. KPMM-ja mund të lëshojë këto Licenca dhe Leje pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e këtyre Licencave dhe Lejeve në bazë të këtij ligji:
 - 1.1. Licenca për hulumtim, sipas Pjesës III të këtij ligji,

- 1.2. Licenca për mbajtjen e të drejtave, sipas Pjesës IV të këtij ligji,
- 1.3. Licenca për shfrytëzim, sipas Pjesës V të këtij ligji,
- 1.4. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta, sipas Pjesës VI të këtij ligji;
- 1.5. Licenca për shfrytëzim zejtari, sipas Pjesës VII të këtij ligji; dhe
- 1.6. Licenca ose Leja në Interes të Publikut, sipas Pjesës VIII të këtij ligji.

Neni 6 **Kriteret e kualifikimit**

1. Personi që dëshiron të marrë ose mbajë një Licencë ose Leje, ose ta vazhdojë ose të pranojë një bartje të një Licence ose Leje ekzistuese, ka të drejtë ta marrë atë nëse:
2. [...]
3. 1.4.1. i posedon burimet financiare dhe është teknikisht i kualifikuar dhe me përvojë për ushtrimin e aktiviteteve sipas Licencës ose Lejes, dhe për zbatimin e detyrimeve të parapara në Licencën ose Lejen në fjalë;
4. 1.4.2. posedon sigurimin për “të gjitha rreziqet” ndaj palëve të treta, që vlen përgjatë gjithë afatit të Licencës ose Lejes, në shumën e arsyeshme minimale të caktuar nga KPMM-ja;

[...]

Neni 56 **Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM**

1. KPMM ka autoritetin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë për të siguruar:
 - 1.1. hulumtimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë dhe shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare në përputhje me këtë ligj dhe Strategjinë Minerare;
 - 1.2. përputhjen e përgjithshme të veprimtarive minerare me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe kushtet e Licencave, dhe Lejeve të lëshuara nga KPMM në përputhje me këtë ligj.
 2. KPMM ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve në vijim, në përputhje me këtë ligj:
 - 2.1. lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e Licencave dhe Lejeve;
- [...]

LIGJI Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 55 **[Rishikimi]**

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:
 - 1.1. pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;
- [...]

Neni 57

1. Rishikimi i vendimeve mund të kërkohej jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit.

2. Nëse pala ka mësuar për shkakun e rishikimit para se të ketë marrë fund procedura para gjykatës, ndërsa këtë shkak nuk ka mundur ta përdorë gjatë procedurës, rishikimi mund të kërkohe brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të vendimit.

3. Pasi të kenë kaluar tre (3) vjet nga data kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, rishikimi nuk mund të kërkohe.

Neni 62

Në procedurën për rishikim do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e këtij ligji për procedurën sipas padisë dhe mjeteve juridike, nëse në nenet 55 deri 61 të këtij ligji nuk është caktuar ndryshe.

Vlerësimi i pranueshmëris se kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

36. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"

37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, paraqet ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtuesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

38. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

39. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr. 29/2021], e 29 prillit 2021, të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikisht përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

41. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
42. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të paraqesë dhe aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave

për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

43. Gjykata rikujton se lidhur me çështjen e ushtrimit të aktivitetit të përpunimit të rërës dhe zhavorrit, nga parashtruesi i kërkesës ishin zhvilluar dy procedura gjyqësore. Procedura e parë ndërlihet me lejen e lëshuar nga KPMM për parashtruesin e kërkesës për një periudhë prej 3 viteve duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara, për ushtrimin e aktiviteteve të saj lidhur me përpunimin e rërës dhe zhavorrit. Në ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes vendimit [02/46] ndaloi eksploatimin e materieve inerte nga shtrati, brigjet dhe hapësirat e lumenjve në territorin e Kosovës. KPMM përmes Aktvendimit [165] të 28 dhjetorit 2011, pezulloj licencën dhe lejet e parashtruesit të kërkesës për ushtrimin e aktiviteteve të saj. Pas ankimimit, KPMM përmes Vendimit [nr.075/2013] në shkallë të dytë konfirmoj Aktvendimin [165] e 28 e Qeverisë të dhjetorit 2011. Kundër vendimeve të lartcekur, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore duke kërkuar anulim të vendimit [nr.075/2013] të KPMM-së. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.621/13] refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se vendimi i atakuar është në interes të përgjithshëm dhe zbatimi i tij është në pajtim me vendimin [02/46] e 2 tetorit 2011, të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pas ankimimit, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.474/17] konfirmoj Aktgjykimin [A.nr.621/13] e Gjykatës Themelore.
44. Ndërsa procedura e dytë ndërlihet me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [AA.nr.474/17] të Gjykatës së Apelit, më konkretisht, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës në procedurën e dytë paraqiti kërkesë për rishikimin e procedurës dhe vazhdimin e procedurës në lenden [Anr.621/13] në Gjykatën Themelore për shkak se sipas parashtruesit ekzistojnë fakte/rrethana të reja tashme në rastin e tij. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.621/13] të 25 gushtit 2020 duke u bazuar në nenin 55 të Ligjit për Konfliktet administrative refuzoj kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se parashtruesi nuk i ka bere te besueshme pretendimet me ndonjë fakt të bazuar në prova konkrete se, ekziston baza ligjore për rishikim të procedurës. Pas ankimimit, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.571/20] dhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr. 29/2021] refuzoj kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se parashtruesi nuk ka ofruar prova në bazë të cilave do të justifikohet kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 55 të Ligjit për Konfliktet Administrative.
45. Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës specifikisht dhe vetëm vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me procedurën e dytë të zhvilluar lidhur me rastin e tij, konkretisht procedurën për rishikim të vendimit që kishte përfunduar me Aktgjykimin [AA.nr.474/17] të Gjykatës së Apelit. Respektivisht parashtruesi para Gjykatës konteston Aktgjykimin [ARJ.nr. 29/2021] e 29 prillit 2021, të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AA.nr.571/20] e 11 shkurtit 2021, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.621/13], e 25 gushtit 2020, të Gjykatës Themelore.
46. Në këtë drejtim, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës i konteston këto vendime të gjykatave të rregullta me arsyetimin se refuzimi i tyre që të i marrin parasysh provat e paraqitura nga ai gjatë procesit gjyqësor, respektivisht ftesën dhe padinë nga Gjykata Themelore Peje - Dega Klinë, sipas lëndës [C.nr. 433/19], sipas se cilës dëshmohej se është paditur nga S.B. dhe S.B. për kompensim demi, lidhur me një kontratë të pa realizuar të lidhura me ta në kohën gjer sa ky subjekt ishte i pajisur me licencë nga KPMM, si fakte/rrethana të reja për aprovimin e kërkesës për rishikimin e vendimit, respektivisht anulimin e Aktgjykimin [A.nr.621/13] të 31 gushtit 2017, të Gjykatës

Themelore dhe vendimit [nr.075/2013] të KPMM-së, përben shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 54 dhe 55 të Kushtetutës.

47. Ne lidhje me këto pretendime Gjykata do të trajtojë edhe do të aplikojë, në rrethanat e rastit konkret, parimet e përgjithshme për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për mjet juridik, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, për të vlerësuar nëse procedurat e ankesës në tërësinë e tyre në rastin konkret, respektivisht në rastet e kërkesës për rishikim të procedurës mund të kenë rezultuar në shkelje të nenit 54 të Kushtetutës.
48. Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës që përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

49. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që neni 54 i Kushtetutës, përbëhet nga dy rregulla por të cilat duhet lexuar së bashku dhe në ndërrvarësi me njëra-tjetrën. Rregulli i parë është i përgjithshëm dhe thekson se *“çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj.”* Në parim, ky rregull nënkupton që mbrojtja gjyqësore është e drejtë e garantuar për secilin individ, fizik apo juridik, të cilit mund të i jetë “shkelur” një e drejtë ekzistuese e garantuar me Kushtetutë ose me ligj apo mund të i jetë “mohuar” e drejta për të fituar apo për të gëzuar ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë ose me ligj. Rregulli i dytë i këtij neni flet dhe garanton të drejtën për “mjete efektive ligjore” në rastet kur konstatohet se një e drejtë e mbrojtur me Kushtetutë apo me ligj është shkelur (Shih rastin e Gjykatës KI48/18, *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 195)
50. Neni 54 i Kushtetutës gjithashtu plotësohet dhe duhet të lexohet ngushtë dhe në lidhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe me nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, siç do të shpjegohet në paragrafët vijues (Shih rastin e Gjykatës KI48/18, cituar me lartë, paragrafi 196).
51. Gjykata vëren që neni 32 i Kushtetutës plotëson të dy aspektet e nenit 54 të Kushtetutës, duke garantuar të drejtën e përdorimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore apo vendimeve administrative e të cilat kanë cenuar të drejtat e garantuara, por duke e kufizuar këtë përdorim në mënyrën e përcaktuar me ligj. Ndërsa, neni 13 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një “zgjidhje efektive” në rast të shkeljes së të drejtave të garantuara me KEDNJ, para një organi kombëtar, përkatësisht para një organi të përcaktuar me të drejtën vendëse.
52. Rrjedhimisht, në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 i Kushtetutës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ.

53. Bazuar ne praktiken e GJEDNJ, esenca e të drejtave të garantuara me nenin 13 të KEDNJ-së, e në kontekstin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me nenin 32 e 54 të Kushtetutës, është e përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër të tjera, përmes rastit Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë, e sipas të cilit: “Neni 13 kërkon që kur një individ e konsideron veten të paragjykuar nga një masë që pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të ketë një mjet juridik përpara një autoriteti kombëtar për të vendosur lidhur me pretendimet e tij dhe nëse është e nevojshme/përshtatshme, për të marrë korrigjim (“redress”). Kështu, neni 13 duhet të interpretohet si garantues për një “mjet efektiv juridik përpara një autoriteti kombëtar” për të gjithë ata që pretendojnë se të drejtat dhe liritë e tyre sipas Konventës janë shkelur.” (Shih rastin e GJEDNJ-së, Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë, nr. 5029/71, Aktgjykim i 6 shtatorit 1979, paragrafi 64).
54. Në këtë kontekst, kur GJEDNJ-ja shqyrton nëse një mjet juridik i ofruar nga shteti përkatës është efektiv ose jo, në thelb ajo përgjigjet në pyetjen nëse mjete i tillë juridik, në rast se do të ishte përdorur, a e ngërthen në vetvete mundësinë dhe kapacitetin që të parandalojnë shkeljen e pretenduar e cila ka ngjarë apo vazhdon të ngjajë, ose për shkeljen e cila ka tashmë ka ndodhur, a do të mundej ankuesi të gjente zgjidhje adekuate. Kjo është pyetja kryesore në të cilën GJEDNJ-ja përgjigjet kur vendos mbi efektshmërinë e një mjeti juridik.
55. Më konkretisht, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dalin kërkesat kryesore për sa i takon një mjet efektiv juridik: (i) kërkesat thelbësore të një mjeti efektiv juridik; (ii) kërkesat institucionale për një mjet efektiv juridik; dhe, (iii) çështja e kumulativitetit të procedurave. Duke marrë parasysh që rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës ndërlidhen kryesisht me shkeljet e pretenduara për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe efektivitetin e mjetit juridik, për shkak se sipas parashtruesit gjykatat e rregullta nuk kishin marre parasysh faktet e reja, respektivisht padinë e S.B dhe S.B për mos përmbushje të kontratës, Gjykata do t'i shtjellojë këto tri kriteret më detajisht në vijim duke i aplikuar ato në rrethanat e rastit konkret.
56. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht “kërkesave thelbësore të një mjeti efektiv juridik”, jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon që për të konsideruar një mjet juridik efektiv ai duhet të jetë: (i) “efektiv në praktikë dhe në ligj”; (ii) efektiviteti duhet të jetë i tillë që të ketë mundësinë dhe kapacitetin që të parandalojë ndodhjen e një shkelje të pretenduar apo vazhdimin e asaj shkeljeje; ose (iii) të jetë një mjet juridik i cili mund të ofrojë korrigjim adekuat për çfarëdo lloj shkelje e cila ka ndodhur. (Shih rastin e GJEDNJ-së, Kudla kundër Polonisë, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000). Nuk ka mjet efektiv juridik asnjëherë në rast se fushëveprimi i rishikimit nga një gjykatë apo autoritet publik i autorizuar që të bëjë rishikim të tillë është aq i dobët sa që e ka të pamundshme të adresojë në mënyrë të duhur elementet kyç rreth asaj se a ka pasur apo jo shkelje të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, Wainwright kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 12350/04, Aktgjykim i 26 shtatorit 2006, paragrafët 53-56).
57. Në këtë kuptim, Gjykata vëren që këto kriteret janë të plotësuara në rrethanat e rastit konkret për arsyet në vijim: (i) mjet juridik për rishikimin e procedurës dhe kushtet për ngritjen e sajë është i përcaktuar në nenin 55, 56 dhe 57 të LKA-se ku në mënyrë specifike neni 55 [Rishikimi] i LKA-se përcakton se:

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur: 1.1. pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë

më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;

58. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për ekzistimin e fakteve/rrethanave të reja në favor të rishikimi të vendimit në rastin e tij, Gjykata thekson se të njëjtat, ishin ngritur pranë Gjykatës Themelore, dhe ishin trajtuar në mënyrë të detajuar nga gjykatat e rregullta.
59. Gjykata, vëren se duke u bazuar në nenin 55 të LKA-së, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Ac.nr.621/13] të 25 gushtit 2020, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

“ [...] shkresa e lartcekur e paraqitur nga paditësja si prove e re nuk ka ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative nga ajo se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë me aktvendimin A.nr.621/13 të datës 31 gusht 2017.

[...] arsyet e paraqitura në kërkesë nga ana e paditësit, nuk lejojnë mundësin e rishikimit të procedurës kjo gjykate e hedhe poshtë kërkesën për rishikimi të procedurës pasi që pala nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e bazës ligjore që ligji e ka përcaktuar për mundësin e rishikimit të procedurës. Nga sa u theksua me lartë, duke u bazuar në nenin 55, 34 dhe nenin 60 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktin Administrativ u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi”

60. Gjithashtu, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr. 571/20] të 11 shkurtit 2021, në kontekst të këtij pretendimi specifik të parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

*“[...]Gjykata e Apelit ka vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit, se tani me në rastin konkret ka prova të reja, përkatësisht padia dhe kontrata e S, S.B., dhe ftesa për Gjykatën e Klinës, për Gjykatën e Apelit ky pretendim është i pa bazë, **për faktin se nuk janë prova të cilat nuk janë vlerësuar edhe me herët**, andaj sipas vlerësimi edhe të kolegjit të Gjykatës se Apelit këto nuk janë prova të cilat nuk janë përdorur në procedurën e mëparshme dhe në bazë të cilave do të mund të merrej vendimin me i favorshëm për palën paditëse – propozues, e rrjedhimisht as arsye të mjaftueshme për të lejuar rishikimin e procedurës në rastin konkret. Po ashtu, kjo gjykate, si gjykate e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrën të plote dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore[...].”*

61. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Arj.nr.29/2021] të 29 prillit 2021, në trajtim të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte sqaruar si në vijim:

“Bazuar në dispozitën ligjore të cituar si me lartë Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e instancave më të ulta kanë vendosur drejtë me hedhjen poshtë të kërkesës së paditësit për rishikimin e procedurës, me të cilin ka kërkuar anulimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së shkallës së parë, A nr.621/13, dt. 31.08.2017, dhe vendimin të organit të paditur të KPMM, nr.K.A.075/2013, të 17.04.2013, si dhe kompensimin e demit në shume prej 1,4118.560.00 012 euro, sepse provat në të cilat bazohet, se ka pranuar një ftesë dhe padi nga Gjykata Themelore Peje-dega Kline, sipas lendes C.nr. 433/19, sipas se cilës dëshmohet se është paditur nga S. dhe S. B. për kompensim demi, lidhur me një kontratë të pa realizuar të lidhura me ta në kohën gjer sa ku subjekti ishte i pajisur me licencë nga KPMM, me të drejtë edhe nga gjykata e apelit janë vlerësuar se nuk janë prova relevante apo me ndikim për tu aprovuar kërkesa për rishikim, prandaj edhe sipas vlerësimit të

Gjykatës Supreme, paditësi nuk e ka bere te besueshme kërkesën për ekzistimin e bazës ligjore, sipas dispozitës se cituar si me lartë nga nenin 55.1.1, të LKA-së për rishikimin e procedurës.

[...] Provat në të cilat thirret nuk janë me peshe juridike për tu lejuar rishikimi i procedurës dhe për tu zgjidhur çështje ndryshe në favor të tij, nga ajo e përfunduar me aktgjykimin e formës se prerë”

62. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht “kërkesave institucionale të një mjet efektiv juridik” për një mjet efektiv juridik, gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Themelore, ajo e Apelit dhe përfundimisht Gjykata Supreme kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Ne lidhje me “kërkesat institucionale të një mjet efektiv juridik” GJEDNJ-ja vlerëson çështjen e pavarësisë së atij “autoriteti publik” si dhe “garancitë procedurale që ai ofron për të determinuar efektivitetin e një mjeti”. Përderisa “pavarësia e autoritetit publik” respektivisht gjykatave të rregullta nuk është kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës, ne lidhje me “garancitë procedurale”, Gjykata ka parasysh se Gjykatat e rregullta në trajtim të rastit të parashtruesit të kërkesës kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe kishin sqaruar se (i) kërkesa e parashtruesit për rishikimi të vendimit nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i nenit 55 të Ligjit për konfliktet administrative; (ii) provat e paraqitura nuk përbejnë bazë për lejimin e rishikimit të procedurës; (iii) dhe provat e paraqitura nuk paraqesin fakte të reja në procedurën konkrete sepse t’ njëjtat janë shqyrtuar gjatë zhvillimit të procedurës se mëparshme (Shih rastin e Gjykatës KI48/18, cituar me lartë, paragrafi 205).
63. Dhe, në fund, sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht, “kumulativitetit të procedurave”, jurisprudenca e GJEDNJ-së tregon që akumulimi i tërësishëm i procedurave dhe i kanaleve të korrigjimit (“redress”) në një sistem ligjor duhet të merret parasysh kur të vendoset lidhur me atë se a ka pasur parashtruesi një mjet efektiv në dispozicion apo jo. Në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka theksuar që edhe nëse asnjë mjet juridik në vetvete nuk mund të përmbushë të gjitha kërkesat e nenit 13 të KEDNJ-së – totali i mjeteve juridike mund të përmbushë ato kërkesa. (Shih rastin e GJEDNJ-së, Surmeli kundër Gjermanisë, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; shih, po ashtu, Leander kundër Suedisë, nr. 9248/81, Aktgjykim i 26 marsit 1987). Në këtë aspekt, Gjykata, duke marrë parasysh që ka tashmë ka konstatuar se kërkesat e dy kritereve të para janë përmbushur, gjithashtu konstaton se procedura në tërësinë e saj ka mundësuar dhe ka ofruar një mjet juridik efektiv në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kriteret për vlerësimin e efektivitetit të një mjeti efektiv juridik në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, janë përmbushur. Gjykata verën se gjykatat e rregullta në rastin e parashtruesit të kërkesës kishin analizuar provat e paraqitura dhe rishikimin e procedurës dhe pretendimet e tjera të ngritura nga parashtruesi dhe në fund kishin refuzuar kërkesën e tij për rishikim të vendimit duke u bazuar në dispozitat përkatëse të LKA-se, respektivisht nenit 55, që ajo kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (Shih rastin e Gjykatës KI48/18, cituar me lartë, paragrafi 205).
64. Gjykata rithekson se efikasiteti i mjeteve juridike të parapara me nenin 54, respektivisht nenin 32 të Kushtetutës, në pajtim me praktiken e GJEDNJ-se, nuk përcaktohet në baze të asaj nëse parashtruesi i kërkesës me shfrytëzimin e tyre ka arritur t’i realizojë qëllimet e tij në mënyrën se si ai kishte synuar, por nëse ai kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai e shfrytëzon të mund të paraqesë argumentet e tij që do të shqyrtohen nga autoritetet kompetente (shih rastin e GJEDNJ-së, Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykim i 7 korrikut 1989,

paragrafi 120, shih gjithashtu rastin KI76/20, *parashtrues Kujtim Zarari*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2020, paragrafi 45).

65. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura në rrethanat e rastit konkret dhe faktet e paraqitura, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se: (i) Aktgjykimi [ARJ.nr. 29/2021] i Gjykatës Supreme, nuk është nxjerrë në shkelje dhe është në përputhshmëri me të drejtat për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54, të së drejtës në mjet juridik efektiv të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.
66. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se *“Komisioni është dashur që vendimet e saj ti bazoj në Ligj për Miniera dhe Minerale si në momentin e dhënies se licencës, ashtu edhe në pezullimin e saj, e jo në vendimet e Qeverisë”*.
67. Gjykata sjell në vëmendje se parashtruesi i kërkesës është duke e kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ.nr. 29/2021], të 29 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, dhe jo kushtetutshmërinë e Vendimit [02/46] të 2 nëntorit 2011, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
68. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 55 të Kushtetutës, por nuk arsyeton dhe nuk shpjegon se si në rrethanat e rastit të tij kjo e drejt mund të jete shkelur. Gjykata rithekson se vetëm përmendja e nenit respektiv, pa mbështetur dhe arsyetuar nuk mund të ngrij çështje për vlerësim pranë kësaj Gjykate.
69. Gjykata gjithashtu rithekson dhe ve theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jene bere nga gjykatat e rregullta, apo instancat tjera përkatëse, gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjshmërisë, përveç; dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetute (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtruesi i kërkesës: *Ramadan Koqinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 55; shih gjithashtu rastin KI40/17 Parashtrues *Muharrem Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2017, paragrafi 35).
70. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetute (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, cituar më lartë, paragrafi 56 dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012, paragrafi 33).
71. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, sepse argumentet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kane mohuar atij të drejtat e garantuar me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.
72. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, nr.5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

73. Bazuar në si me sipër, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 tetor 2022, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani